



Shkurtimisht për:

Të ardhmen e gazit në Kosovë

Janar 2023

HYRJE¹

Gazi natyror në të gjitha format e tij, pas naftës dhe thëngjillit, sot përbën një nga burimet fosile kryesore energjetike. Në pjesën dërmuese të vendeve të Evropës, gazi ende mbetet nga burimet më të rëndësishme energjetike qoftë për nevoja të industrisë apo edhe ekonomive familjare. Nga ana tjetër Marrëveshja e Gjelbër (eng: “Green Deal”) e Bashkimit Evropian (BE) parasheh që deri në vitin 2050 Evropa të bëhet kontinenti i parë me emetim net zero të gazrave serë. Kjo iniciativë implikon fillimin e një procesi të reduktimit të ndjeshëm të përdorimit të burimeve fosile si burime energjetike. Megjithatë, kriza e fundit energjetike dhe përshkallëzimi i luftës në Ukrainë kanë bërë që BE t’i ri klasifikojë gazin dhe energjinë nukleare si burime “të pastra” për një periudhë tranzitore duke i hapur kështu mundësi financimit të investimeve që përdorin këto dy burime. Përpjekjeve globale për neutralitetin klimatik iu janë bashkangjitur edhe vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë edhe Kosovën, përmes marrëveshjes së ashtuquajtur Agjenda e Gjelbër e Ballkanit Perëndimor. Kjo marrëveshje konsiston në zotime nga të gjitha vendet e rajonit në përafrimin e veprimeve dhe politikave me vendet e BE-së në përpjekjet globale për neutralitetin klimatik deri në vitin 2050. Duke qenë që sektori energjetik, më saktësisht prodhimi i energjisë elektrike në Kosovë është i bazuar kryesisht në burimet fosile (termocentralet me linjit), vendit i duhet një strategji dalëse e cila në tridhjetë vitet e ardhshme do ta pavarësojë tregun nga burimet jo të pastra të energjisë. Duke u gjendur përballë kësaj shtate si dhe duke pasur parasysh burimet ende të kufizuara të energjisë së ripërtëritshme, gazi do të mund të konsiderohej një alternativë që do të adresonte kërkesat për energji për një periudhë tranzitore deri në ndalimin e plotë të prodhimit të energjisë nga burimet fosile. Sidoqoftë, në dokumentet kryesore strategjike të energjisë në të kaluarën nuk mund të thuhet se ka pasur ndonjë vizion lidhur me mundësitë e gazifikimit të sektorit të energjisë (p.sh. termocentralet me gaz), apo investimeve në rrjet për nevoja të industrisë dhe ekonomive familjare. Ngjashëm, Draft Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031 nuk parasheh ndonjë mundësi për investime qoftë në kapacitete të reja gjeneruese apo investime tjera në infrastrukturë të gazit. Arsyet kryesore që ndërliidhen me hezitimin e qeverisë në investime të tilla, gjithnjë duke u bazuar në këtë dokument, kryesisht ndërliidhen me situatën aktuale gjeopolitike dhe pasiguritë lidhur me furnizimin e Evropës me gaz si dhe çmimet e larta të kësaj lënde fosile. Gjithsesi, vlen të theksohet që kjo strategji nuk përjashton eksplorimin e mundësive që do të mund të lidhnin tregun e Kosovës me rrjetin e furnizimit me gaz qoftë përmes Maqedonisë së Veriut apo Shqipërisë.

Në kuadër të aktiviteteve të rregullta avokuese, Instituti Riinvest përmes platformës Green Action Space në fund të muajit dhjetor të vitit të kaluar kishte organizuar një diskutim në panel ku është trajtuar në mënyrë të thelluar e ardhmja e gazit në kontekstin aktual gjeopolitik dhe mundësitë që Kosova ka në zhvillimin e tregut energjetik dhe rritjen e sigurisë energjetike në vend përmes iniciativave të ndryshme që ndërliidhen me gazin. Ky dokument përmbledh shkurtimisht disa nga çështjet kryesore që janë trajtuar në këtë diskutim.²

¹Publikuar nga Instituti Riinvest. Ky dokument është nxjerrë nga seria e debateve ‘Green Talks’ në kuadër të platformës Green Action Space, iniciativë e përbashkët e Institutit Riinvest dhe Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Institutit Riinvest.

²Në këtë diskutim në panel, vëmendje të veçantë mori çështja e gazifikimit të linjitet dhe mundësia e rivitalizimit të rrjetit të furnizimit me gaz nga Maqedonia e Veriut. Të ftuar për të diskutuar në panel ishin z. Geri Selenica, Drejtor i Përgjithshëm i Qendrës Shqiptare për Studime Strategjike, z. Luan Shllaku ekspert i fushës si dhe Drejtor i Përgjithshëm i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur, si dhe z. Sabit Restelica, Konsulent i Lartë për Çështje Mjedisore.

MUNDËSITË E GAZIFIKIMIT TË SEKTORIT ENERGJETIK NË KOSOVË

Duke pasur parasysh faktin se Kosova është një nga vendet me rezervat më të mëdha të linjtit në botë, dhe gjithashtu duke pasur parasysh kufizimet gjithnjë e më të ashpra sa i përket përdorimit të linjtit si burim primar për prodhimin e energjisë, në diskutimet lidhur me këtë temë mbretëroi mendimi se çështja e mundësive dhe kushteve për gazifikimin e linjtit duhet të trajtohet me ndonjë studim fizibiliteti në dritën e zhvillimeve të reja teknologjike. Ndonëse një mundësi e tillë nuk trajtohet në dokumentet aktuale strategjike dhe nuk shihet si alternativë në një të ardhme të afërt, rekomandimet nga seria e debateve në kuadër të "Green Talks" ishin që Kosova duhet të jetë e përgatitur me studime që pasqyrojnë mundësitë dhe kufizimet eventuale në aspektin ekonomik, teknologjik dhe mjedisor.

Pavarësisht investimeve dhe përmirësimeve në kapacitetet ekzistuese gjeneruese dhe në rrjet, furnizimi i paqëndrueshëm dhe kërkesa gjithnjë e në rritje për energji elektrike shpërfaqin nevojën imediate për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe diversifikim të burimeve të energjisë. Pasiguria në furnizim me energji elektrike mund të shndërrohet në pengesë serioze për zhvillim dhe rritje ekonomike. Andaj, krahas krijimit të parakushteve për investime në burime të ripërtëritshme, mundësitë për rritje të kapaciteteve të energjisë bazë (eng: baseload) duke përdorur gazin sintetik të krijuar nga linjiti nuk duhet përjashtuar apriori. Vlen të theksohet se në të kaluarën, më konkretisht gjatë viteve të 70-ta dhe viteve të 80-ta Kosova ka prodhuar sasi gazit sintetik.³ Pavarësisht që kapacitetet nuk ishin aq të mëdha dhe tani teknologjia është e stërvjetëruar dhe e njëjta nuk mund të përdoret në ditët e sotit, teknologjitë e reja mundësojnë që i gjithë procesi i prodhimit të gazit sintetik të bëhet në mënyrë të pastër përderisa sasia e ndotjes do të ishte e papërfillshme dhe brenda parametrave të lejuar me standardet e ditëve të sotit.⁴ Për më tepër, nga ky proces do të mund të prodhoheshin edhe produkte sekondare siç janë plehrat artificiale.⁵ Pra, duke pasur parasysh rrethanat aktuale të cilat kanë mundësuar që gazi të trajtohet si burim i "pastër" për një periudhë tranzitore deri në vitin 2050, pasuritë e Kosovës me thëngjill mbeten një potencial i madh energjetik në tri dekadat e ardhshme qoftë për rritjen e kapaciteteve të reja energjetike apo edhe atyre termike duke furnizuar kështu ngrrohtoret me lëndë djegëse. Sipas ekspertëve, rezervat aktuale të thëngjillit janë të mjaftueshme për të siguruar prodhimin e gazit sintetik për nevojat e sektorit të energjisë përgjatë kësaj periudhe tranzitore jo vetëm për të plotësuar nevojat e brendshme mirëpo edhe për eksport qoftë si produkt final apo në formë të energjisë elektrike duke përdorur këtë burim.

Një nga mundësitë e gazifikimit të pjesshëm të sektorit të energjisë që nxiti debate dhe diskutime brenda qarqeve politike por edhe shoqërisë civile ishte mundësia e lidhjes së Kosovës në rrjetet e furnizimit me gaz natyror të lëngshëm (LNG) apo gaz natyror të kompresuar (CNG). Më konkretisht, janë dy mundësi që aktualisht Kosova ka; lidhja përmes tubacionit SKOPRI (Shkup-Prishtinë) nga Maqedonia e Veriut, si dhe tubacionit nga Shqipëria i ashtuquajtur ALKOGAP. Duhet thënë që tashmë ekziston lidhja me tubacionin SKOPRI pavarësisht që infrastruktura mund të jetë e vjetërsuar dhe mund të mos jetë adekuate për transportimin e gazit. Andaj, duke pasur parasysh këtë fakt programi i ashtuquajtur Kompakt për Kosovën i financuar nga Korporata Sfidat e Mijëvjeçarit (eng. Millennium Challenge Corporation) kishte paraparë mundësinë që fondin prej rreth 200 milionë dollarësh ta orientojë në investime për gazifikimin e sektorit energjetik të

³ Sasia e prodhuar e gazit sintetik asokohe është përdorur kryesisht për furnizimin me lëngë djegëse të Ngrrohtores së qytetit të Prishtinës "Termokos" si dhe për disa kapacitete industriale g Trpeça, Ferronikeli dhe Hekurana e Shkupit).

⁴ Prodhimi i gazit sintetik liron 50% më pak dioksid karboni krahasuar me djegien e qymyrit.

⁵ Gjatë procesit të prodhimit të gazit sintetik nga linjiti lirohen gazra si hidrogjeni apo metani.

Kosovës. Me konkretisht, ky fond ishte propozuar nga donatori që të përdorej pjesërisht për rehabilitimin e tubacionit SKOPRI apo edhe për ndërtimin e një termocentrali të ri me gaz i cili do t'i shtoj kapaciteteve ekzistuese energjetike bazë dhe kësaj do t'i garantonte siguri energjetike Kosovës për një periudhë afatgjate. Rehabilitimi i rrjetit ekzistues nga tubacioni SKOPRI do t'i mundësonte Kosovës importimin e gazit të lëngshëm nga porti i Selanikut (Greqi) përmes territorit të Maqedonisë së Veriut. Madje, për një investim të tillë ishte hartuar edhe studimi i parafizibilitetit nga ekipe ekspertësh të angazhuar nga Korporata Sfidat e mijëvjeçarit.⁶ Ky studim, krahas alternativave të tjera, parashihte si mundësi të mirë revitalizimin e rrjetit ekzistues (SKOPRI) si një zgjidhje të përshtatshme për tranzicionin energjetik në Kosovë. Megjithatë, Qeveria e Kosovës kishte refuzuar një propozim të tillë duke e arsyetuar me çmimet e larta të gazit si pasojë e krizës energjetike dhe pasiguritë që ndërliken me këtë burim të energjisë. Si kundërpropozim qeveria kishte kërkuar nga donatori përkrahjen në investime për kapacitetet e ruajtjes (bateritë) së energjisë elektrike që do të instalohen në vitet në vijim. Pra, pavarësisht mundësive reale për investime në gazifikimin e sektorit energjetik në Kosovë, deri më sot nuk ka pasur ndonjë vizion të qartë strategjik lidhur me gazin nga qeveritë e ndryshme nga viti 2008 e këtej. Aktualisht, Minsitria e Ekonomisë është duke hartuar master planin për gazin i cili pritet të ofrojë informacione të detajuara rreth investimeve në infrastrukturë si dhe mundësitë për përdorim të gazit. Mirëpo, nuk ka indikacione nëse i njëjti master plan parasheh edhe investime në kapacite gjeneruese të energjisë me gaz sidomos duke pasur parasysh faktin që një gjë e tillë nuk parashihet në Strategjinë e re të Energjisë.

REKOMANDIME RRETH TË ARDHMES SË GAZIT NË KOSOVË

Në vijim janë paraqitur disa nga sugjerimet dhe rekomandimet e nevojshme që burojnë nga vlerësimi i dokumenteve strategjike si dhe mundësive investive në dritën e ndryshimeve gjeostrategjike dhe qasjes së re të vendeve të Bashkimit Evropian sa i përket gazit dhe përdorimit të tij për nevoja të sektorit të energjisë:

- Draft-strategjia e energjisë në versionin e saj final do të duhej të trajtonte me kujdes mundësitë për ndërtimin e një sistemi me bazë gazi natyror në Kosovë. Një analizë e tillë, sipas draft-strategjisë, është duke u bërë në Master Planin e Gazit dhe në studimin e fizibilitetit për tubacionin e interkoneksionit të gazit në mes të Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës, megjithatë e njëjta duhet të reflektohet në strategji.
- Të rishikohen mundësitë për bashkë-investime me donatorë të ndryshëm apo Institucionet Ndërkombëtare Financiare për rehabilitimin e rrjetit ekzistues të tubacionit SKOPRI i cili do të mund të shërbente për nevoja të industrisë dhe gjithashtu ekonomive familjare në të ardhmen.
- Duke pasur parasysh zhvillimet teknologjike që reduktojnë ndjeshëm ndotjen gjatë procesit të gazifikimit të linjtit, draft-strategjia e re duhet të mos anashkalojë edhe mundësinë e gazifikimit të linjtit për periudhën tranzitore energjetike në vend.

⁶ Studimi i parafizibilitetit është hartuar nga konsorciumi [Bleack & Veatch](#), [Abkons](#), dhe Navita, për Korpusin e Inxhinierëve të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Distrikti për Evropë.

- Qeveria e Kosovës, të iniciojë hartimin e studimit të fizibilitetit lidhur me mundësitë potenciale dhe limitet e zhvillimit të industrive moderne të gazifikimit të linjtit në Kosovë në dritën e zhvillimeve aktuale dhe të pritura teknologjike.